

**OBLIGIMET E KOMUNAVE NGA AGJENDA EVROPIANE
PLANI GJITHËPËRFSHIRËSE I KOMUNAVE JANAR-DHJETOR 2024**

Data e dorëzimit të raportit:	6.1.2025
Emri i komunës	Kryeqyteti Prishtina
Emri i Kryetarit të Komunës	Përparim Rama
Emri i zyrtarit komunal për Integritet Evropian :	Ajshe Bërveniku
Detajet kontaktuese:	ajshe.berveniku@rks-gov.net

• **BLLOKU I: KRITERET POLITIKE**

1. ADMINISTRATA PUBLIKE		Neni 120 i MSA-së: Administrata publike	
1.1. Forcimi i kapaciteteve të administratës në nivelin lokal, përfshirë komunat e sapoformuara, duke ofruar udhëzime nga niveli qendror tek ai lokal.	Të gjitha Drejtoritë/ Njësitë/ burimet njerëzore	1. A është hartuar programi i trajnimeve për vitin 2024 në komunën tuaj? <i>Nëse po, ju lutemi të ofroni një dokument të tillë.</i>	1. Programi i trajnimeve për vitin 2024 është hartuar, e gjeni të bashkëngjitur.

<p>1.2.Të ngritet transparenca e punës dhe vendimmarrjes të nivelit lokal</p>	<p>Zyra e Kryetarit /Zyra e informimit</p>	<p>1. A ka hartuar komuna juaj Startegjinë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun, nëse po ju lutem të bashkangjiteni strategjinë e miratuar?</p> <p>2. A ka komuna juaj Planin vjetor të komunikimit, nëse po ju lutem të bashkangjiteni Planin ?</p> <p>3. A është duke u zbatuar Udhëzim Administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për Administratë të hapur në Komuna.</p> <p>4. A është caktuar zyrtari përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik në komunën tuaj? Ju lutem bashkangjiteni vendimin.</p> <p>5. Lidhur me rezultatet e procesit të konsultimit publik, a publikon komuna juaj raportin me të gjitha propozimet e ofruara nga qytetarët, si dhe a ofron sqarimet e nevojshme lidhur me arsyet e refuzimit të kërkesave të qytetarëve apo</p>	<p>1. Kabineti i Kryetarit ka hartuar strategjinë e brendshme të komunikimit me publikun, e cila pastaj shërben si udhëzues për mënyrën e qartë dhe konkrete të komunikimit me publikun, qytetarët dhe grupet tjera të interesit. Për interesin tuaj të bashkëngjitur në formatin PDF gjeni strategjinë e komunikimit;</p> <p>2. Plan vjetor zyrtar të komunikimit nuk ka, përveç strategjisë së lartpërmendur, kurse krahasimisht me planin vjetor të Kuvendit komunal, si dhe planeve tjera të drejtorive, do të punohet për vitin e ardhshëm - 2025, një plan i veçantë për komunikim me publikun e gjërë;</p> <p>3. Udhëzimi administrativ (MAPL) nr. 04/2023 për Administratë të hapur në komuna zbatohet në një përqindje të caktuar, kjo arsyetohet me të qenit e Komunës së Prishtinës në “top 10 komunat” sa i përket transparencës në dy vitet e fundit, pastaj në pjesëmarrjen e qytetarëve nëpër konsultime publike, ftesën publike që ua bën Komuna atyre e kështu më radhë;</p> <p>4. Zyrtari përgjegjës për koordinimin e procesit të konsultimit publik është caktuar sipas Vendimit të Kryetarit.</p>	
---	--	---	--	--

		grupeve të tjera të interesuara. (ju lutem e bashkangjitni linkun e publikimit të raporteve)?		
3.SHOQËRIA CIVILE				
3.1.Të rritet bashkëpunimi në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të Qeverisë së Kosovës, si dhe të sigurohet financim publik për shoqërinë civile	Drejtoria për Financa dhe Buxhet	<p>1. Sa ka ndarë buxhet komuna juaj për mbështetjen e projekteve të OSHC-ve konform Rregullores 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publikë të OJQ-ve?</p> <p>2. Sa është numri i OSHC-ve të përkrahura financiarisht nga komuna juaj ?</p> <p>3. A ka përkrahur komuna juaj, projekte të OJQ-ve për përkrahjen e komuniteteve.</p> <p>4. Nëse po, specifikoni numrin e projekteve të përkrahura dhe ju lutem ofroni shumën totale të këtyre projekteve?</p> <p>5.A është bërë publikimi i thirrjeve dhe përfituesve në web faqet zyrtare të Komunës, nëse po</p>	<p>1. Buxheti i miratuar per vitin 2024 ne kategorinë e subvencionimeve, është 5,500,000.00 €;</p> <p>2. Në vitin 2024 janë përkrahur gjithsej gjerë me tani 404 OJQ, që ne vlerë përkrahëse kap shumën prej 2,489,700.00 €, nga të cilat 8 janë çerdhe në komunitete, të cilat çdo muaj përkrahen në bazë të kriterit të fëmijëve prezentë mujorë dhe kapin shumën përkrahëse vjetore 241,700.00 €;</p> <p>3. Publikimet e thirrjeve dhe përfituesit sipas programeve të drejtorive shpallen ne ueb-faqet e Komunës së Prishtinës - “Prishtina online”.</p> <p>- Drejtoria e Mirëqenies Soiale</p> <p>3. DMS ka përkrahur projektet e komuniteteve të OJQ-ve përmes “Thirrjes publike “;</p> <p>4. Janë përkrahur 2 (dy) OJQ: - OJQ “Fondacioni Terre Des Hommes Lausanne në Kosovë TDHK ”,</p>	

		bashkangjit linkun.	<p>vlera totale prej 7,000.00 € (shtatë mijë euro) dhe - OJQ “ Rrjeti i Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptian të Kosovës “ RROGRAEK, vlera totale 15,300.00 € (pesëmbëdhje mijë e treqind euro).</p> <p>4. https://prishtinaonline.com/lajmet/4155/lis-ta-e-perfituesve-te-thirrjes-publike-per-ofrimin-e-sherbimeve-sociale-nga-drejtoria-per-mireqenie-sociale</p> <p>Thirrja e parë publike</p> <p>https://prishtinaonline.com/lajmet/4155/lis-ta-e-perfituesve-te-thirrjes-publike-per-ofrimin-e-sherbimeve-sociale-nga-drejtoria-per-mireqenie-sociale</p> <p>dhe Thirrja e dytë Publike</p> <p>https://prishtinaonline.com/lajmet/4213/lis-ta-e-perfituesve-te-thirrjes-publike-per-perkrahje-financiare-te-projekteve-te-ojq-ve-per-sherbime-sociale-e-familjare</p>	
4.LUFTA KUNDËR TERRORIZMIT			Neni 92: Lufta kundër terrorizmit - MSA	

<p>4.1.Të përforcohen strukturat e Kosovës në parandalimin dhe eliminimin e akteve terroriste dhe financimit të tyre</p>	<p>Drejtoria e Arsimit/Zyra e Kryetarit</p>	<p>1. A keni organizuar ndonjë trajnim ose fushatë vetëdijësuese për parandalimin e të rinjëve që janë në rrezik për ekstremizëm dhe se si të veprojnë në raste të tilla ?</p> <p>2. Cilat janë veprimet/aktivitetet që ka ndërmarrë komuna e juaj për vetëdijësimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shpiej në ekstremizëm të dhunshëm ?</p> <p>3. A ka pasur ndonjë rast të raportuar në KKSB për aktivitetet që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin?</p>	<p>.1. Drejtoria e Arsimit nuk ka organizuar ndonjë trajnim ose fushatë vetëdijësuese për parandalimin e të rinjëve që janë në rrezik për ekstremizëm;</p> <p>1. Sa i përketë aktiviteteve apo veprimeve për vetëdijësimin e qytetarëve kundër radikalizmit që mund të shpiej në ekstremizëm të dhunshëm, Drejtoria e Arsimit nuk ka ndërmarrur asnjëherë ndonjë veprim a aktivitet me qytetarë.</p> <p>Në Drejtorinë e Arsimit nuk është raportuar ndonjë aktivitet që lidhet me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin nga KKSB;</p>	
<p>4.2.Të krijohen mekanizma për raportim obligativ lidhur me konfliktin e interesit si dhe të ashpërsohen sanksionet lidhur me mos deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesit , si dhe për zbatimin e politikave të tjera kundër korrupsionit</p>	<p>Kordinatori i Sekretariatit/ Kuvendi i Komunës</p>	<p>1. Sa është numri i rasteve të paraqitura të konflikteve të interesit nga zyrtarët komunal?</p> <p>2. Sa është numri i anëtarëve të kuvendit që kanë deklaruar konfliktin e interesit para marrjes së vendimeve në kuvend të</p>	<p>1. Eshtë paraqitur një rast dhe është konfirmuar që është konflikt interesi (të bashkëngjitur E-mailin).</p> <p>2. Asnjë rast nuk është deklaruar;</p>	

		komunës?		
4.3.Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsion;	Kordinatori i Sekretariatit/ Kuvendi i Komunës	<p>1. A ka hartuar komuna juaj Planin Lokal për Integritet, konform Ligjit Nr. 08/L-017 për agjencin për parandalimin e korrupsionit nëse po ju lutem të bashkangjiteni planin e miratuar?</p> <p>2. A ka komuna juaj koordinator që monitoron dhe raporton lidhur me planin për integritet, nëse po ju lutem të bashkangjitni vendimin.</p>	<p>1. Plani është hartuar konform Ligjit;</p> <p>2. Po, me vendim të Kryetarit është emëruar koordinatori për raportimin e Planit të integritetit;</p> <p>https://prishtinaonline.com/uploads/vendim_-_ajshe_berveniku.pdf</p>	
4.4.Të përmirësohet implementimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve	Zyra ligjore/Zyra informimit	<p>1 Çfarë veprime ka ndërmarrë Komuna për të krijuar qasje për shërbime në gjuhët zyrtare në nivel komunal, duke përfshirë gjuhët në përdorim zyrtarë, sipas UA. Nr. 01/2022.</p> <p>2.A publikohen të gjitha aktet komunale në gjuhët</p>	<p>1. Në kuadër të Sektorit të Kuvendit janë të angazhuar dy përkthyes Shqip - Serbisht dhe të gjitha dokumentet (që kërkohen sipas UA) përkthehen në kohë dhe afat të caktuar;</p> <p>2. Të gjitha aktet komunale përkthehen dhe publikohen në gjuhën serbe.</p>	

		zyrtare ashtu sic parashihen me ligjin për përdorimin e gjuheve si dhe rregullores komunale për gjuhët zyrtare?		
--	--	---	--	--

5. MBROJTJA DHE PROMOVIMI TRASHËGIMISË KULTURORE				
---	--	--	--	--

<p>5.2.Të implementohet legjislacioni që ka të bëjë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore</p>	<p>Drejtoria e Kulturës/ Drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë (Urbanizmi)</p>	<p>1. A ka hartuar komuna juaj Planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore konform Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore ?</p> <p>2. Nëse jo cilat janë sfidat/arsyjet që komuna juaj ende nuk e ka hartuar Planin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore ?</p> <p>3. Sa është numri i shkeljeve dhe ndërtimeve ilegale në zonat e mbrojtura?</p> <p>4. Çfarë masa janë ndërmarrë ndaj shkeljeve të evidentuara të ndërtimeve pa leje në zonat e mbrojtura?</p> <p>3.A janë siguruar pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave të tërësive të objekteve të trashëgimisë kulturore (objektet e kultit fetar, zonat e mbrojtura, muzetë, etj) ?</p> <p>6. A janë nënshkruar Memorandume të bashkëpunimit për detyrat dhe përgjegjësitë për mirëmbajtjen e Kishave Ortodokse? (Vetem komunat që kanë kisha) ?</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Komuna e Prishtinës nuk ka sektor të veçantë për Trashëgimi kulturore; - Projektet që kanë të bëjnë me Trashëgimi kulturore, të gjitha bëhen në koordinim me Institucionet përkatëse për Trashëgimi kulturore, Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore - Prishtinë dhe Instituti i Kosovës për Mbrojtje të Trashëgimisë Kulturore. <p>Komuna e ka pëgatitur Planin zhvillimor komunal 2024-2032, ku përfshihet edhe plani për mbrojtjen e Trashëgimisë kulturore.</p>
---	--	--	---

<p>5.6. Raportoni lidhur me organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe promovimin e përkushtimit më të fuqishëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore</p>	<p>Drejtoria e Kulturës</p>	<p>1.Listoni aktivitetet që komunat ka ndërmarrë për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore ?</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Aktivitetet gjatë periudhës raportuese janar – qershor 2024, janë : - Drejtoria e Kulturës ka projekte të ndryshme për promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Promovimi bëhet në kuadër të promovimit turistik të qytetit të Prishtinës, ndërsa mbrojtja e trashëgimisë bëhet me anë të projekteve të konservimit dhe restaurimit të ndërtesave dhe pjesëve të Qytetit, në bashkëpunim me institucionet kompetente; - Në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, jemi në proces të krijimit të muzeut “Shtëpitë Shkolla”; - Kanë përfunduar punimet e projektit: “Rigjenerimi i rrugës “Mehmet Kaçurri” (rruga Model) në zonën e vjetër të qytetit, e cila do të shërbejë si model për rigjenerimin e pjesëve tjera në zonën historike të kryeqytetit; - Për nder të Ditës Ndërkombëtare të Monumenteve Kulturore, “Sahat Kulla” ka qëndru e hapur për vizitorë. - Drejtoria e Kulturës ka iniciuar dhe organizuar ngjarje të ndryshme kulturore, në bashkëpunim me komunitetin artistik, në hapsirat e objekteve të Trashëgimisë kulturore, me qëllim të promovimit të hapsirave përmes Artit dhe Kulturës. Vlen të theksohet se aktivitetet kryesore në objekte të trashëgimisë që janë realizuar, 	
--	------------------------------------	--	--	--

janë si në vijim: Promovimi i revistës “Prishtina Art”, në ish bibliotekën “Hivzi Sulejmeni”, ekspozita e Lale Vulës, në Hamamin e Madh, ekspozita me performanca artistike “Ky është një titull i fuqishëm”, me rastin e shënimit të 16-ditëve të aktivizmit”, në Hamamin e Madh, si dhe ekspozita “Reporting Hause” në objektin e ish-Gërmisë etj.

Po ashtu, përmes subvencioneve kemi një numër të projekteve që janë në procedurë të vlerësimit nga komisioni për trashëgimi kulturore:

2. BLOKU II: KRITERET EKONOMIKE

1. EKZISTENCA E EKONOMISË FUNKSIONALE TË TREGUT

1.1. Përmirësimi i mëtejshëm i ambientit në të bërit biznes si dhe procedurat e planifikimit të buxhetit

Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

1.A është themeluar Qendra për regjistrimin e bizneseve (*one-stop shopet*) në komunën tuaj?

2. Sa është numri i inspektorëve të tregut në komunën tuaj?

3. Sa është numri i inspektimeve gjatë periudhës raportuese?

1. Kryeqyteti nuk e ka Qendrën për Regjistrimin e Bizneseve, shërbehet me të dhënat nga ARBK;
2. N/A;
3. N/A;
3. Gjatë muajve korrik-gusht të vitit 2024, janë mbajtur gjithsej **10 dëgjime publike** për buxhetin për vitin 2025:
 - 5 dëgjime publike janë mbajtur për të gjitha fushat dhe drejtoritë që Komuna i ka planifikuar t'i ndajë për vitin 2025, dhe ato janë mbajtur 5 (pesë) të ndryshme në sallën e Kuvendit;
 - Ndërsa 5 dëgjime të tjera janë mbajtur jashtë Komunës në lagje dhe fshatra të ndryshme të Kryeqytetit, ku janë ndarë 1,000,000.00 Euro për këto pesë lokalitete. Për secilën nga 200,000.00 Euro;

Shënimet për pikën 5,6 dhe 7 gjenden ne ARBK;

4. Sa dëgjime publike janë mbajtur për planifikimin e buxhetit?

5.Sa është numri i bizneseve të regjistruara, ju lutem ofroni të dhëna vetëm për periudhën raportuese Janar-Qershor 2024 ?

6. Sa është numri i bizneseve të mbyllura, ju lutem ofroni të dhëna vetëm për periudhën raportuese Janar-Qershor 2019 ?

7.Sa është numri i bizneseve të udhëhequr nga gratë?

8.Sa ka ndarë buxhet komuna juaj për subvencionimin e bizneseve?

Pas mbajtjes së 5 (pesë) dëgjimeve buxhetore, ku janë marrë propozimet dhe idet nga qytetarët, më pas janë mbajtur edhe pesë takime të tjera, ku janë votuar dhe janë futur në buxhetin për vitin 2025.

2.1.Zvogëlimi i nivelit të ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal;	Drejtoria e Inspektoriatit	1. Cilat janë masat që ka ndërmarrë komuna juaj ndaj subjekteve ekonomike me qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale ?		
2.2. Zbatimi i Reformës së Menaxhimit të Financave Publike		<p>1. Sa rekomandime ka dhënë Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) në raportin më të fundit për Komunën tuaj.</p> <p>2. Sa rekomandime të ZKA-së i keni adresuar?</p> <p>3. Sa rekomandime të ZKA-së kanë mbetur pa u adresuar?</p> <p>4. Sa rekomandime të ZKA-së gjenden në proces?</p> <p>5. A funksionon Njësia e Auditimit të Brendshëm në komunën tuaj, nëse po sa zyrtarë janë të angazhuar në këtë njësi?</p> <p>6. A ka themeluar komuna juaj komitetin për auditim të brendshëm?</p>	<p>Komuna ka hartuar Planin për implementimin e rekomandimeve. Në Plan janë paraparë të gjitha veprimet të cilat do të ndërmerren për përmirësimin e të gjeturave. Po ashtu, janë caktuar zyrtarët përgjegjës për ato rekomandime, si dhe janë caktuar afatet kohore;</p> <p>2. ZKA, në raportin e fundit janë dhënë 22 rekomandime;</p> <p>3. Janë zbatuar 10 rekomandime;</p> <p>4. Kanë mbetur 8 pa u zbatuar;</p> <p>5. Ndërsa 4 rekomandime janë në proces;</p> <p>6. NJAB funksionon në Komunën e Prishtinës dhe ka 5 auditorë;</p> <p>7. Gjatë vitit 2024 janë bërë 8 auditime;</p> <p>8. Janë kryer 4 auditime në drejtorinë e Inspeksionit, 2 auditime në Drejtorinë e Arsimit, Investime Kapitale, Drejtorinë e Shëndetësisë, Prokurim, Administratë dhe Bujqësi;</p> <p>9. Auditim i performances është bërë në Drejtorinë e Shëndetësisë;</p>	

2.3. Planfikimi i pronës komunale për zhvillim ekonomik lokal		1. A është publikuar regjistri i pronës komunale, bashkangjitni linkun i regjistrit të pronave në kuadër të ueb faqeve zyrtare të komunave ?	https://prishtinaonline.com/uploads/lista_e_pergjithshme_e_pronave_te_palujshme_komunale_2023.pdf https://prishtinaonline.com/uploads/lista_e_vecante_e_pronave_per_dhenie_ne_shfrytezim%20(1).pdf	
3. NDËRMARRJET DHE POLITIKAT E INDUSTRIË				
13				
3.1.Ndërtimi i një infrastrukture fizike, të kompletuar dhe të gatshme për ushtrimin e veprimtarive të bizneseve		1. A është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike në komunën tuaj?	1. Jo, ende nuk është bërë funksionalizimi i zonave ekonomike;	
3. BLOKU III: STANDARDET EVROPIANE				
1. BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL				Neni 26 i MSA-së: Bujqësia dhe Peshkataria
1.1. Rregullimi i mëtejshëm i tokës bujqësore dhe mbrojtjes nga ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore	Drejtoria për Bujqësi	1. A ka hartuar komuna juaj Plan Program për Bujqësi dhe Zhvillim Rural nëse po ju lutemi na bashkangjitni planin e miratuar? 2. Sa është numri i kërkesave të parashtruara për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore? 3. Sa është numri i vendimeve të miratuara për	1. Komuna nuk ka plan-program për bujqësi dhe zhvillim rural; 2. Për periudhën kohore 1.1.2024, deri më sot (11.6.2024), janë pranuar gjithsejtë 14 kërkesa për pëlqim për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në ndërtimore; Ndërsa nga data 11.6.2024 deri më sot (16.12.2024), janë pranuar gjithsejtë 26 kërkesa për pëlqim për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore në ndërtimore; Për periudhën janar – dhjetor 2024, i bie 40 kërkesa ; Ndërsa, 3 kërkesa të tjera janë përcjellë në Drejtorinë e Kadastrit, për pagesë të kompesimit për ndërrim të tokës bujqësore;	

		<p>ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore?</p> <p>4.A keni raste në komunën tuaj të humbjes së tokës Bujqësore?.</p>	<p>3. Prej tyre, 9 kërkesa janë përcjellë në MBPZHR për trajtim të mëtejme, përkatësisht për dhënien e pëlqimit përkatës dhe një tjetër është në trajtim.</p> <p>Për periudhën kohore të referuar, nga MBPZHR janë pranuar gjithsejtë 5 pëlqime; Për periudhën qershor – dhjetor nga MBPZHR janë pranuar 23 pëlqime, e që në total për gjithë vitin i bie 28 pëlqime.</p>	
<p>1.2.Konsolidimi i mëtejme i qendrave informative këshilluese komunale për bujqësi dhe zhvillim rural</p>	<p>Drejtoria për Bujqësi</p>	<p>1. A janë funksionalizuar qendrat informative për këshillimin e fermerëve në komunën tuaj?</p> <p>2.A ka mbështetur komuna juaj fermerët në sektorin e drithrave, hortikulturës, blegtorisë etj nëse po ju lutem cekni sektorin dhe numrin e fermerëve të përkrahur?</p>	<p>1. Po, është themeluar Qendra dhe është funksionale;</p> <p>2. Komuna e Prishtinës ka përkrahur fermerët në disa sektorë për periudhën raportuese dhe atë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lavërtari, janë përkrahur gjithësej 10 fermerë me nga një makinë për mbjelljen e grurit; - Prodhimtari bimore, janë përkrahur gjithësej 90 fermerë me nga një makin – frezë për punimin e tokës, frezë 1.8m, 60 fermerë dhe frezë 2.0m, 30 fermerë; - Pemëtari, janë përkrahur gjithësej 27 fermerë me nga një set për mirëmbajtje të pemishtes; - Prodhimtari bimore, janë përkrahur gjithësej 29 fermerë me nga një plug dy brazë. - Shpezëtari, janë përkrahur gjithësej 5 ferma komerciale, me numër të shpezëve (pula vojëse) 25500 copë, në vlerë prej 19,890.00€. 	

			<p>- Blegtori, janë përkrahur 231 fermerë, gjedhe qumështore dhe buallica 1476 krerë, si dhe dele dhe dhi qumështore 3351 krerë, në vlerë prej 109,986.54€, po ashtu, në Blegtori janë përkrahur gjithësej 7 fermerë me nga një mikser për ushqim voluminoz të kafshëve; janë përkrahur gjithësej 6 fermerë me nga një rimorkio për shpërndarjen e plehut të shtallës; si dhe janë përkrahur gjithësej 39 fermerë prodhues të qumështit, gjithësej 513,811L, me nga 0.05€ për litër, gjithësej 25,690.55€.</p> <p>- Bletari, janë përkrahur gjithësej 209 bletarë, me 5511 shoqëri bletësh, në vlerë prej 69,989.70.</p> <p>- Perimtari, janë përkrahur gjithësej 91 fermerë me nga një serrë 500 m² dhe 200 m², 68 fermerë janë përkrahur me serra me sipërfaqe 200m² dhe 23 fermerë me serrë me sipërfaqe 500m²; janë përkrahur gjithësej 7 fermerë me nga një makinë për mbjelljen e fidanëve të perimeve.</p>	
1.3. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e tokës bujqësore	Drejtoria për Bujqësi	1.Çfarë veprime ka ndërmarr komuna juaj për parandalimin e humbjes së tokës bujqësore?		
1.4. Planet për menaxhimin e tokave rurale (zonimi)	Drejtoria e Bujqësisë	1. A posedon komuna e juaj Planin për Menaxhimin e tokave rurale, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar ?	Jo, Komuna nuk e ka Planin për menaxhimin e tokave rurale.	

ENERGIJA				Neni 114 Energjia- MSA
2.1. Reformimi i strukturave institucionale në fushën e energjisë dhe ngritja e kapaciteteve të tyre, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe acquis-së së transpozuar	Drejtoria e Shërbimeve Publike	<p>1. A ka miratuar komuna juaj Planin për Efiqencë të Energjisë, konform Ligjit për Energji Elektrike nëse po, ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar ?</p> <p>2. Cilat janë projektet konkrete për zbatimin e planit për eficientë të energjisë, specifikoni së paku tri projekte?</p>	<p>1. Hartimi i Planit komunal për energji dhe klimë është në përfundim dhe pritet miratimi në Kuvend komunal (ende nuk është miratuar);</p> <p>2.</p> <p>a) Projekti i zgjerimit të ndriçimit publik, ku janë realizuar deri më tani 128 rrugë, me gjatësi 41.1km dhe 1461 trupa ndriques, si dhe ndërrimi i llmpave nga 250WNa në 150W LED sasia mbi 170 copë;</p> <p>b) Është nënshkruar kontrata, ku kanë filluar punimet për zbatimin e masave eficiente në ndërtesat - Banesat e Socialit në Kolovicë, si dhe Hajvali nga Fondi për efiqencë të energjisë;</p> <p>c) Jemi në pritje të lidhjes së kontratave me KFW për zbatimin e masave eficiente në shkollën Hasan Prishtina e cila pritet të përzgjedhet.</p>	
4. GJYQËSORI DHE TË DREJTAT THEMELORE				
4.1.Zbatimi i pakove ligjore për të drejtat e njeriut		<p>1. A është emëruar zyrtari përkatës për mbrojtjen nga diskriminimi ?</p> <p>2.A është emëruar zyrtari përkatës për Barazi Gjinore?</p> <p>3. Sa ka ndarë buxhet komuna juaj për zhvillimin</p>	<p>1. Është emëruar me këtë titull, zyrtare për koordinimin e të drejtave të njeriut, barazi gjinore dhe për mbrojtje nga diskriminimi;</p> <p>2. Shih përgjigjen 1;</p> <p>3. Kryeqyteti ka ndarë 20 000 euro për zhvillimin e aktiviteteve në fushën e të drejtave të njeriut.</p>	

	Njësia për të Drejtat e Njeriut	e aktiviteteve në fushën e të drejtave të njeriut ?		
4.2 Zbatimi i pakove ligjore për kujdesin për të moshuarit		<p>1.A ofron Komuna juaj përkujdesje rezidenciale për të moshuarit, konform legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë?</p> <p>2.Nëse po, sa qendra të përkujdesjes për të moshuarit gjenden në Komunën tuaj?</p>	<p>3. Po, ka hartuar Planin lokal të veprimit 2023-2025</p> <p>https://prishtinaonline.com/uploads/6.1_plani_lokal_i_veprimit_per_mbrojtje nga dhuna ne familje 1.pdf</p> <p>https://kk.rks-gov.net/prishtine/wp-content/uploads/sites/45/2023/02/3.-Vendimi-per-miratimin-e-Planit-te-veprimit-per-mbrojtje-nga-dhuna-ne-familje-2023-2025.pdf</p> <p>4. Srehimorja: 34 gra dhe 52 femijë</p> <p>QPS totali 182, gra 158, meshkuj 24 dhe fëmijë 201;</p> <p>1. Po, e kemi të themeluar Këshillin komunal (komitet) për mbrojtën e viktimave të dhunës në familje dhe ka mbajtur 2 takime gjatë periudhës raportuese, janar – qershor 2024;</p> <p>- Drejtoria e Mirëqenies Sociale</p> <p>1. Është institucioni i kujdesit rezidencial, që ofron shërbime dhe strehim për personat e moshuar pa përkujdesje familjare;</p>	<p>Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Minsitrisë së Financave dhe Transfereve dhe Komunës së Prishtinës</p>

			<p>2. Po, është një (1) qendër, Shtëpia për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë – SHPMPF;</p>	
--	--	--	--	--

4.2.Të drejtat e grave dhe barazia gjinore

Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete

2. A ka hartuar komuna juaj Planin e Veprimit kundër dhunës në familje, konform strategjisë kombëtare nëse po ju lutem të bashkangjiteni dokumentet e miratuar ?

3. Sa raste të dhunës mbi baza gjinore ka trajtuar komuna juaj dhe sa janë trajtuar ?

4.Cfarë masa ka ndërmar komuna juaj për viktimat e dhunës në familje konform ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje ?

5.A ka themeluar komuna këshillin komunal (komitet) për mbrojtën e viktimave te dhunës në familje, nëse po sa takime janë mbajtur?

3. Drejtoria e Mirëqenis Sociale ka mbështetur me përkrahje financiare përmes subvencioneve 20 raste të viktimave të dhunës në familje, vlera totale 50,700.00 € (pesëdhjetë mijë e shtatëqind euro).

<p>4.3.Të fuqizohet roli dhe pozita e grave në shoqëri</p>	<p>Njësia për të Drejtat e Njeriut</p>	<p>1. Sa është numri i grave në pozita menaxheriale në të gjitha institucionet e komunës duke përfshirë dhe komunitetin jo shumicë (p.sh. administratë, shkolla, QMF etj) ?</p> <p>2.Sa është numri total i përfaqësimit të grave në administratën publike lokale duke përfshirë Kuvendin e Komunës, dhe komunitetin jo shumicë ?</p> <p>3. Sa është numri i grave që janë Drejtore të Drejtorive në Komunën tuaj?</p>	<p>1. Në Administratën e Kryeqytetit janë 15 gra në pozita menaxheriale;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në Qendrën e Mjekësisë Urgjente janë 5 gra në pozita menaxheriale; - Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare nga gjithsej 77 pozita menaxheriale, 58 janë gra, 19 burra; <p>2. Në Administratën e Kryeqytetit, nëpunë civilë janë gjithsej 548, nga ta janë 295 femra dhe 253 meshkuj; Nga 51 anëtarë të Kuvendit të Kryeqytetit, 17 janë gra, ndërsa 34 burra; Ndërsa komplet Kryeqyteti, duke i përfshirë Administratë, nëpunësit civil, nëpunësit publikë, si dhe Qendra për Punë Sociale, totali është 660, 341 femra dhe 319 meshkuj;</p> <p>1. Janë 8 gra në pozitën drejtore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Drejtoria e Administratës’ - Drejtoria e Pronës; - Drejtoria e Arsimit, njëkohësisht edhe nënkrytare; - Drejtoria e Mirëqenies Sociale; - Drejtoria e Kulturës; - Drejtoria e Financave; - Drejtori e Parqeve; - Drejtoria e Bujqësisë; 	
--	--	--	--	--

4.4.Zbatimi i të drejtave pronësore	Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete/Zyra për Barazi Gjinore	1. Cilat janë veprimet që ka ndërmmarr komuna juaj me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe përmirësimit për të drejtat pronësore të grave, dhe cila është natyra e tyre?	1. Udhëzim administrativ (qrk) nr. 02/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit administrativ (qrk) nr. 03/2016, për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve;	
		2. Sa prona janë të regjistruara në emër të dy bashkëshortëve?	2. 637 prona në emër të dy bashkëshortëve	
4.5. Zbatimi i Ligji për Mbrojtjen e fëmijës		<p>1. Cilat janë sfidat me të cilat ballafaqësohet komuna juaj në zbatimin e ligjit për mbrojtjen e fëmijës?</p> <p>2.A është themeluar ekipi për të drejtat e fëmijës sipas UA.06/22 .</p> <p>3. A është organizuar ndonjë fushatë vetëdijësuses-edukese në komunën tuaj mbi promovimin dhe njohjen e të drejtave të fëmijëve në kuadër të EDF.</p> <p>4. A është caktuar zyrtari përkatës për mbrojtjen e fëmijës ?</p> <p>5. A janë të qasshme për</p>	<p>1. Mungesa e infrastrukturës ligjore e paraparë me Ligj, e cila është përgjegjësi e nivelit qendror per financim dhe ndërtim, sidomos të shtëpisë per fëmijë.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mungesa e resurseve njerëzore të shërbimeve sociale në Qendër për Punë Sociale, për të ofruar shërbime sociale në nevojë për të gjithë fëmijët nga kategoritë e ndryshme në nevojë; - Mungesa e buxhetit të QPS për të mbështete nevojat dhe aktivitetet për ofrim të shërbimeve sociale e profesionale; - Shërbimet e qëndrueshme ditore dhe të strehimit për fëmijët e rrezikuar; - Mosndërtimi i shtëpisë për mbrojtjen e fëmijëve; - Institucionet lokale, siç janë QPS dhe mekanizmat e tjerë që janë të paraparë sipas Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve dhe ligjeve tjera; <p>2. Po, është themeluar me vendim të Kryetarit;</p>	

personat me aftësi të kufizuara, hapësirat e punës në institucionet publike?

6.A janë të qasshme objektet arsimore për personat me aftësi të kufizuar?

7.A kane asistencën e duhur në procesin mësimor fëmijët me aftësi të kufizuar, sipas legjislacionit të zbatueshëm në Kosovë?

8. A ofron Komuna Juaj kujdestari për fëmijës pa përkujdesje prindërore sipas formave themelore të mbrojtjes juridike dhe familjare, bazuar në legjislacionin në fuqi.

3. Asambleja Komunale e Fëmijëve është organ legjitim i përfaqësimit të fëmijëve në vendimmarrje në nivelin lokal, dhe është ambient ku vazhdimisht promovohen liritë dhe të drejtat e fëmijëve;

Aktivitete:

- Mbledhja e parë 2024 , Asamblesë së Fëmijëve të Kryeqytetit, u diskutua plani i punës të aktiviteteve për 2024 dhe bashkërendimi i aktivisteve edhe me organizatat të cilat kanë në fokus të drejtat e fëmijëve. Gjithashtu, gjatë këtij takim u diskutua edhe për të gjitha problemet me të cilat po ballafaqohen, si mungesa e kabineteve dhe pajisjeve për lëndë të ndryshme;

- Organizimi i trajnimit *për* rolin e shkollës për parandalimin dhe adresimin e rasteve të dhunës në baza gjinore, ku duhet të raportohen rastet, roli i psikologëve, mësimdhënësve në përfshirjen e këtyre temave në lëndet mësimore, format e dhunës në baza gjinore, procedurat standarde të veprimit dhe puna në grupe

- Asambleja e Fëmijëve të Kryeqytetit - Prishtinë, takim me Avokatin e Popullit, z.Naim Qelaj;

Në fjalën e tij hyrëse, Avokati i Popullit foli për mandatin dhe kompetencat e tij në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve, dhe për departamentin e veçantë që punon për të drejtat e fëmijëve, që nga promovimi dhe mbrojtja, e deri në hetimin e ankesave. Avokati i Popullit po ashtu i njoftoi të pranishmit për punën e bërë gjatë vitit të kaluar, ku institucioni ka pranuar gjithsejtë 79 ankesa që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve. Nga ky numër, janë hapur 46 raste për hetim ndërsa ankesat janë bërë ndaj komunave, gjykatave, ndaj ministrive, përfshirë edhe Qendrat për Punë Sociale.

Fëmijët theksuan shqetësimet tjera, duke përfshirë çështjen e privatësisë së fëmijëve, siguria në shkolla, mungesën e psikologëve nëpër shkolla, bullizmi, dhe fëmijët në situatë rruge;

- Organizimi i trajnimit në kuadër të programit në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe qeverisjes me të drejtat e tyre “Detyrimi ynë për të ardhmen - Mbrojtja e fëmijëve dhe qeverisja e të drejtave të fëmijës” në bashkëpunim me organizatën “Syri i Vizionit”, në partneritet me “Save the Children”, zyra në Kosovë, dhe financohet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar;

- Organizmit i mbledhejs solemne të Asamblesë së Fëmijeve të Kryeqytetit me rastin e ditës “1 Qershori”

Asamblistët e kryeqyteteit paraqitën kërkesat në emër të bashkëmoshatarëve të tyre drejtuar Kryetarit të Kryeqytetit dhe drejtorëve të drejtorive. Ne fund, u nënshkruan zotimet nga Kryetari dhe u nda mirënjohje. Aktivitetet kanë vazhduar pasataj edhe me takimet tjera në Qeverinë e Kosoves , me Zyën për qeverisje të mirë” etj.

4. Jo, nuk është emëruar, është i angazhuar me punë shtesë dhe pa vendim;

5. Në vazhdimësi Komuna punon në përmirësimin e qasjes së personave me aftësi të kufizuara në objekte pubike dhe shkollore është punuar, por ka ende punë për t’u bërë;

6. Qendra për Punë Sociale:

Qendra për Punë Sociale si institucion i vëncante i nivelit lokal, kryen të gjitha veprimet kur kërkohet që të ofrohet mbrojtje juridike dhe sociale për fëmijët pa kujdes prindëror. Përfshirë kujdestarinë,

strehimin familjar, strehimin rezidencial, adoptimin. Të gjitha këto kryehn në përputhje me nevojat e vlerësuara dhe specifike të fëmijëve dhe familjeve. Sipas dispozitave ligjore e nënligjore që e rregullojnë fushën në fjalë;

7. Komuna e Prishtinës e ka të themeluar Qendrën për Punë Sociale, e cila është e mandatur për të ofruar shërbime për fëmijët dhe familjet. Sipas legjislacionit primar dhe sekondar që e rregullojnë fushën e shërbimeve sociale dhe familjare dhe përgjegjësinë e institucioneve, Organi i Kujdestarisë është përgjegjës për të kryer të gjitha veprimet për mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror dhe të aplikojë format e mbrojtjes juridike dhe sociale në përputhje me interesat e fëmijës dhe legjislacionit në fuqi:

- Kujdestaria;
- Strehimi familjar;
- strehimi rezidencial;
- adoptimi;
- jetesa e pavarur e mbikëqyrur.

Drejtoria e arsimit

<p>4.6.Lufta kundër trafikimit me qenie njerëzore</p>	<p>Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete /Drejtoria për Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale</p>	<p>1. A është e hapur fushata vjetore në parandalimin e trafikimit me njerëz në Komunën tuaj? Nëse po ju lutem renditni aktivitetet?</p> <p>2.A e ka të miratuar Komuna Juaj Planin trevjeçar për strehim Social konform Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit ? Nëse po ju lutem ta bashkëngjitni Planin?</p>	<p>1. Po, është mbajtur nga 18 tetori deri më 19 nëntor 2024;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Organizimi i fushatës “ Tetori muaji kundër trafikimit me qenien njerëzore”; <p>Moto: “Bashkë kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, si dhe lansuar videon me mesazhe.</p> <p>RAPORO ! 0800 11 112 ose 192 antitrafikimi@kosovopolic.com</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbledhja e mbajtur në sallën e Kuvendit, ku hapjen e kësaj fushate e bëri nënkryetarja e kryeqytetit, znj. Jehona Lushaku - Sadriu, pastaj diskutuam fenomenin dhe mekanizmat mbështetës pranë Kryeqytetit. U shfaq video me mesazhe e punuara nga Asambleja e fëmijëve të kryeqytetit. Në fund u hap ekspozita se si nxënësit e shkollave tona shohin trafikimin në formë artistike me pikturim. Fushata ka vazhduar në shkolla të kryeqytetit, duke pas një laramani të informimit, ku asamblistët e Kryeqytetit kanë përgatitur për bashkëmoshatarët e tyre ese, poezi, aktrim dhe ligjërata, dhe kemi shfaqur video mesazhin dhe kemi dërguar fletëpalosjet dhe në fund kemi hapur edhe diskutimin. Nxënësit kanë qenë të interesuar lidhje me këtë fushat dhe kanë bërë pyetje prej më të ndryshmeve. <p>Gjithashtu, kemi qenë pjesë në emisione televizive.</p> <p>2. Komuna nuk e ka të miratuar Planin trevjeçar për strehim social.</p>	
<p>4.7.Incimi i funksionalizmit të Komunitetit Konsultativ për Personat em Aftësi të Kufizuar</p>		<p>1. A është themeluar Komiteti konsultativ për Personat me aftësi të kufizuara në komunën tuaj? Nëse po sa takime ka mbajtur?</p>	<p>1. I ka kaluar mandati në tetor të vitit 2023, dhe më nuk është themeluar.</p>	

<p>4.8. Ofrimi i ndihmës juridike falas për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, pa dallim etnie.</p> <p>7 (shtatë) regjione të Republikës së Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjakovë dhe Gjilan.</p>	<p>Drejtoria e Administratës</p>	<p>1.A është funksionalizuar Zyra Rajonale për ndihmë juridike falas ? (Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Ferizaj, Gjakovë).</p> <p>2. A janë themeluar në komunë tuaj Zyrat mobile për ndihmë juridike falas si formë e organizimit të shërbimeve juridike konform Ligji nr. 04/1-017 për ndihmë juridike falas</p> <p>3. Sa është numri i kërkesave për ndihmë juridike falas në komunën tuaj?</p>	<p>1. Përfituesit e shërbimeve e shfrytoznë shërbimin e ndihmës juridike falas përmes Agjencionit për ndihmë juridike falas.</p>	

5 .MBROJTJA E MINORITETEVE

5.1. Buxheti dhe sfidat në nivel qendror dhe lokal		1. Sa është numri i të punësuarave në të gjitha institucionet e komunës, nga komunitet jo shumicë në pajtim me përqindjen e popullatës në komunë?	1. Në administratën e Kryeqytetit, nëpunës civil janë: - 538 shqiptarë; - 5 serbë; - 2 boshnjak; - 2 turq; - 1 ashkali.	
5.2. Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Komunitetet Rom dhe Ashkali, përmirësimi i shkallës së regjistrimit civil për komunitetet rom, dhe ashkali	Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim	1. A është realizuar fushata për regjistrimin falas të Komuniteteve Rom Ashkali dhe Egjiptian? 2. A është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në komunën tuaj, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni këtë Plan? (për komunat që i kanë këto komunitetet) 3. A është themeluar komiteti lokal veprues për zbatimin e Strategjisë për komunitetin Rom dhe Ashkali.	1. Kryeqyteti ka realizuar fushatën për regjistrimin falas të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, nga data 15.5.2024 deri më 15.6.2024; 2. Po, është miratuar Plani lokal i veprimit për integrimin e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian për vitet 2023- 2025. 3.	

6. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA				Neni 83 Liria, Siguria dhe Drejtësia- MSA
6.1.Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës së politikave në fushën e migracionit, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe të legjislacionit të përafuar	Zyra Komunal për Kthim dhe Komunitete	<p>1.A është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Riintegrim në komunën tuaj, nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar?</p> <p>2.A ka themeluar komuna juaj Komisionin Komunal për Riintegrim (KKR)?</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Plani lokal i veprimit 2023-2025 për riintegrimin është miratuar; 2. Po, komisioni është caktuar me vendim të Kryetarit, 01. nr.14-020/04-54807/22, më 11.3.2022, është funksional dhe mbanë takime të rregullta. 	
7.MENAXHIMI I KUFIJVE DHE MIGRIMIT				Neni 85- Vizat,menaxhimi i kufijve, azili dhe migracioni-MSA
7.1. Ofrimi i mundësive për kthim për personat e zhvendosur	Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim/ Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenës Sociale	<ol style="list-style-type: none"> 1. Sa është numri i personave të zhvendosur të rikthyer, të cilët janë regjistruar në komunën tuaj? 2. Sa është numri i shtëpive të (ri)ndërtuara për të rikthyerit? 3. Sa është numri i aplikimeve për asistencë nga 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Gjatë periudhës raportuese nuk kemi pasur kthim të personave të zhvendosur; 2. Gjatë kësaj periudhe nuk kemi pasur ndërtim as rindërtim të shtëpive; 3. Janë gjithsejtë 10 familje në Asistencë; 4. 20 persona kanë aplikuar për plane biznesi. 	

		fondi për ri-integrime? 4. Sa është numri i aplikimeve për zhvillimin e bizneseve nga personat e riatdhesuar?		
7.2. Puna dhe roli i Këshillat Lokale për Siguri Publike, (KLSP) dhe Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi, (EVS) të cilat përveç që duhet të jenë funksionale ato duhet të jenë edhe produktive	<p style="text-align: center;">Zyra e Kryetarit Komunes</p>	1. A është themeluar KKSB në Komunën Tuaj? 2. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga KKSB ? 3. A është themeluar Këshilli Lokal për Siguri Publike (KLSP) në komunën tuaj ? 4. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga (KLSP) ? 5. A është themeluar EVS në Komunën tuaj? 6. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga EVS ?	1. Më 18.3.2022, është themeluar KKSB, me mandat katërvjeçar; 2. Gjatë vitit 2024, në gjatëmujorin e parë të këtij viti, është mbajtur vetëm një takim, më 22.3.2024, deri në fund të qershorit do të mbahet edhe takimi i dytë; 3. Në Komunën e Prishtinës janë themeluar dhjetë KLSP; 4. Takimet e KLSP-ve mbahen në baza mujore, që do të thotë se deri më tani secila duhet t'i mbajë nga gjashtë takime, por nuk kemi të njoftuar nga sa janë mbajtur; 5. EVS është themeluar. Nuk është mbajtur asnjë takim, arsyeja është se nuk kemi anëtarë, janë larguar pothuajse të gjithë, për arsye shëndetsore, pensionim, kanë lëshuar punën etj. Është bërë kërkesa në MAPL vite me parë për rivitalizimin e listave të anëtarëve.	

		<p>7. A janë themeluar Këshillat e Fshatrave në komunën tuaj konform Udhezimi Administrativ 02/2019 MAPL për bashkpunimin e komunës me fshatra, nëse po të bashkëngjiten vendimet përkatëse?</p> <p>8. Sa takime kanë mbajtur në këtë periudhë?</p>		
8. ARSIMI DHE KULTURA				Neni 107 Arsimit dhe trajnimi - MSA
8.1. Ngritja e kapaciteteve teknike për Arsimin Gjithpërfshirës	Drejtoria e Arsimit	<p>1. Sa trajnime janë mbajtur gjatë periudhës raportuese për mësimdhënës ?</p>	<p>1. Trajnim për psikologë; 2. Trajnim për asistentë me nevojë të veçanta; 3. Trajnim për mësimdhënës.</p>	
8.2. Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor dhe fëmijët me nevojë të veçanta	Drejtoria e Arsimit	<p>1. Sa është numri i çerdheve funksionale (<i>publike dhe jopublike</i>) në komunën tuaj?</p> <p>2. Sa është numri i fëmijëve prej moshës 0-5 vjeç që janë të përfshirë në çerdhe?</p> <p>3. Sa është numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara të cilët janë të përfshirë në çerdhe?</p>	<p>1. Numri i çerdheve publike funksionale në komunën e Prishtinës është 8, dhe numri i çerdheve jopublike (me bazë në komunitet) është 9;</p> <p>2. Numri i fëmijëve prej moshës 0-5 vjeç, që janë të përfshirë në çerdhe në komunën e Prishtinës është 1762;</p> <p>Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara në çerdhet e komunën e Prishtinës është 48.</p>	

<p>8.3. Raportim me të dhëna mbi numrin e braktisjes së shkollimit nga komuniteti pakicë, në veçanti komuniteti Rom Ashkali Egjiptian. Veprimet konkrete të ndërmarra nga komuna në parandalimin e mëtejshëm të braktisjes së shkollimit</p>	<p>Drejtoria e Arsimit</p>	<p>1.Komuna juaj a has në mungesë të librave shkollore në gjuhët e komuniteteve pakicë?</p> <p>2.Sa është numri i rasteve të braktisjes së shkollimit nga komuniteti jo shumicë?</p> <p>3.A ka organizuar komuna juaj trajnime për ekipet e parandalimit të braktisjes së shkollës, nëse po ju lutem specifikoni numrin e trajnimeve?</p> <p>4. A ka hartuar komuna juaj Planin e veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mosregjistrimit e shkollimit për komunitet jo shumicë (rom dhe ashkali)</p>	<p>1. Komuna e Prishtinës nuk ka hasur në mungesë të librave shkollore në gjuhët e komuniteteve pakicë, sepse çdo vit shkollore bëhet furnizimi me literaturë;</p> <p>2. Nga komuniteti joshumicë në vitin akademik 2023-2024, kemi të raportuar 3 raste të braktisjes së shkollimit;</p> <p>3. Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës ka formuar ekipin për parandalim të braktisjes dhe mosregjistrim të fëmijëve për komunitetet jo shumicë; Ekipi i sapoformuar është në proces të hartimit të planit të veprimit për braktisje;</p> <p>4. Plani i veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mosregjistrimit e shkollimit për komunitetin jo shumicë</p>	

		<p>konform strategjisë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare, nëse po ju lutemi të bashkangjiteni këtë Plan?</p> <p>5. A janë formuar ekipet për parandalimin e braktisjes së nxënësve në shkolla në komunën tuaj?</p>	<p>(Rom dhe Ashkali) në komunën e Prishtinës është në proce e sipër;</p> <p>5. Të gjitha shkollat kanë formuar ekipet për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimin e fëmijëve jo shumicë në shkollat e Prishtinës dhe janë funksionale.</p>	
9. MJEDISI				Neni 115 Mjedisi- MSA
<p>9.1. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë</p>	<p>Drejtoria e Shërbimeve Publike</p>	<p>1. A është hartuar plani komunal për menaxhimin e mbeturinave konform ligjit nr. 04/1-060 për mbeturina. Nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar?</p> <p>2. Sa është numri i fushatave të ndërmarra për ndërgjegjësimin publik për sistemin e menaxhimit të mbeturinave?</p>		

3.Cilat janë veprimet e ndërrmara nga komuna e Obiliqit për mbrojtjen e qytetarëve lidhur me mbylljen e liqenit të depozitës së hirit të qymyrit që operohet nga KEK-u dhe deponisë së Mirashit ?
Obiliqi

4. A është hartuar plani i veprimit për cilësinë e ajrit në komunën tuaj, konform Ligjit nr. 03/1-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja nëse po ju lutemi na bashkangjiteni planin e miratuar (*shihni nëse Planet lokale të veprimit për cilësinë e ajrit janë pjesë integrale e planeve lokale për mjedis*) ?

9.2 Numri i madh i deponive ilegale duhet të adresohet urgjentisht

Drejtoria e Shërbimeve Publike

1. Sa është numri i deponive ilegale në komunën tuaj dhe çfarë masa ka ndërmarrë komuna për të eliminuar këto deponi?

10. MBROJTJA E KONSUMATORIT DHE E SHËNDETIT PUBLIK

Neni 81 Mbrojtja e konsumatorit- MSA

<p>10.1 Mbrojtja e Shëndetit të Nënës, Fëmijës dhe Shëndetit Riprodhues</p>	<p>Drejtorja e Administratës /Drejtorja e shëndetësis</p>	<p>1. A ka pasur fushata vetëdijësues në komunën tuaj lidhur me shëndetin riprodhues ?</p> <p>2.Sa trajnime ka organizuar komuna juaj për shëndetin e nënës dhe e fëmijës?</p> <p>3. A janë të qasshme objektet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuar?</p>	<p>1. Gjatë priudhës raportuese kanë qenë këto aktivitete:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shënimi i javës së ndërgjegjësimit për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës; 2. Mbajtja e 3 ligjëratave vetedijësuese, me gratë në komunitet; 3. Organizimi i tryezës së rumbullakët, me datë 24 janar, në sallën e trajnimeve të QKMF-së; 4. Më 6 shkurt zhvilluan sesione ligjëruese, vetedijësuese per parandalimin e kancerit të qafës së mitrës për mësimdhënësit dhe nxënësit e klaseve të 8-ta dhe të 9-ta në SHFMU-te më të aferta të Prishtinës, si dhe në ambientet e QMF-ve me pacientet dhe komunitetin; 5. Në SHFMU “Pjetër Bogdani”, në prani të mësimdhënësve të kësaj shkolle u mbajt ligjërata edukuese, këshilluese për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës. U shpërndanë materiale për edukim shëndetësor, broshura; 6. Në SHFMU “Ismail Qemali” për mësimdhënësit dhe nxënësit e klaseve të 9-ta të kësaj shkolle, u mbajt ligjërata edukative, shëndetësore, këshilluese, informuese lidhur me parandalimin e kancerit të qafës së mitrës; 7. Në SHFMU “Afrim Gashi” Veternik, u mbajt ligjërata edukative “Parandalimin i Kancerit te Qafës së Mitrës” ku morën pjesë nxënësit e klasëve të 8-ta dhe 9-ta. U shpërndanë materiale për edukim shëndetësor, broshura; 8. Në ambientet e QMF 5 “Dardani”, u mbajt ligjërata vetëdijësuese, edukuese për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës për pacientët dhe komunitetin, u shpërndanë materiale për edukim shëndetësor, broshura; 	
---	---	--	---	--

- | | | | | |
|--|--|--|---|--|
| | | | <p>9. Në QMF –Besi, në ambientet e kesaj qendre me pacientët dhe komunitetin u mbajt ligjërata edukuese për parandalim të kancerit të qafës së mitrës. U shpërndanë materiale për edukim shëndetësor, broshura;</p> <p>10. Në emisionin televiziv drejtpërdrejt “Vaksinimi kundër HPV-së”, procesi dhe pikëpyetjet- “Kosova Today” - Klan Kosova;</p> <p>11. Fëmijë dhe familje” - SOS Fshatrat e Femijeve Kosovë, u mbajt ligjëratë ndërgjegjësuese, ku morën pjesë 50 nëna mbi parandalimin e kancerit të qafës së mitrës. Kjo ligjëratë jo vetëm që u perputh me nevojën për informacion dhe kujdes mjekësor të nënave, por ishte edhe gjest nderimi dhe vlerësimi për ato në Ditën e Gruas, e cila rastis më datën e prezentimit të ligjëratës.Gjatë aktivitetit u shpërndanë materiale edukativo-shëndetësore;</p> <p>12. Janë mbajtur tri ligjërata ndërgjegjësuese për Parandalimin e Kancerit Cervikal- rëndësia e Pap testit” me gratë-zyrtare police të Kosovës, në sallën “Orion” më:
 Grupi i parë, më 14 tetor 2024, 26 pjesëmarrëse,
 Grupi i dytë, më 29 nëntor 2024, ishin 13 pjesëmarrëse;
 Grupi i tretë, më 13 dhjetor 2024, në të cilën ligjëratë ishin 26 pjesëmarrëse. Në total kanë qenë 65 pjesëmarrëse;</p> <p>13. Në janar 2024, në shenjë të Javës Evropiane të Kancerit Cervikal”, është mbajtur ligjëratë ndërgjegjësuese për parandalimin e kancerit cervikal – rëndësia e “Pap testit” me Org. Fondi i Aftësisë së Kufizuar;</p> | |
|--|--|--|---|--|

14. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur këto trajnime:
Shëndeti Seksual dhe Riprodhues për Pacientët me Aftësi të Kufizuar; 30-31 mars 2024, 4-5 prill 2024, 30-31 tetor 2024;
15. Tryezë me menaxhmentin e QKMF të KPSH, për trajnimet e shëndetit riprodhues AMC, me mbështetjen e UNFPA, 03 qershor 2024.

2. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur këto trajnime:
 - Shëndeti Seksual dhe Riprodhues për Pacientët me Aftësi të Kufizuar; 4-5 prill 2024;
 - Tryezë me menaxhmentin e QKMF të KPSH për trajnimet e shëndetit riprodhues AMC, me mbështetjen e UNFPA-së, 3 qershor 2024;
 - "Planifikimi familjar", që mbahen më 29 – 31.

Sa i përket pjesëmarrësve në trajnimin e organizuara nga Komuna e Prishtinës për shëndetin e nënës dhe fëmijës:

Janë trajnuar gjithsej **18 mjekë** dhe **36 infermierë**.

Në trajnimet për GMCD kanë marrë pjesë gjithsej **30 pjesëmarrës**.

3. Po, të gjitha objekte shëndetësore kanë qasje personat me aftësi të kufizuar.

--	--	--	--	--